

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1036 Prot.

Tiranë, më 02.082017

VENDIM Nr. 150, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të projektit "*Projekti i Rikualifikimit në zonën urbane pranë Qendrës së qytetit të Vlorës*" -subjekti Bashkia Vlorë, realizuar nga ASHA,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të projektit "*Projekti i Rikualifikimit në zonën urbane pranë Qendrës së qytetit të Vlorës*" -subjekti Bashkia Vlorë, realizuar nga ASHA.
2. Bashkia Vlorë duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me DRKK Vlorë, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për projektin "*Projekti i Rikualifikimit në zonën urbane pranë Qendrës së qytetit të Vlorës*", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

